

## REKOMANDIME PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT PËR TË NDËRTUAR REZISTENCË SHOQËRORE NDAJ EFEKTEVE TË DËMSHME TË DEZINFORMATAVE

Si rezultat i procesit të hulumtimit dhe analizës së të dhënave në kuadër të aktiviteteve për luftimin e dezinformatave, të plotësuar përmes procesit të konsultimeve të hapura ndërmjet Fondacionit për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”, Këshillit për Etikën në Media (KEMM), Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikatës së Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (SGPM), Institutit për Media dhe Analitikë (IMA), OJQ-Infocentar, Qendrës për Zhvillimin e Mediave (QZHM), Asociacionit Qytetar MOST, Institutit për Shkenca Shoqërore dhe Humane - Shkup (IOHN-S), CIVIL - Qendrës për Liri dhe një sërë ekspertësh dhe përfaqësuesish të palëve të interesuara nga sektori civil, publik dhe privat, grupi fillestar i organizatave i propozon rekomandimet në vijim si bazë për veprim të përbashkët shoqëror për zgjidhjen e këtij problemi shoqëror.

### REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Nevojitet një qasje sistematike për të ndërtuar një kulturë të mendimit kritik dhe të dialogut shoqëror në të gjitha nivelet, duke filluar nga sistemi arsimor, marrëdhëniet ndërmjet institucioneve dhe palëve të interesuara në të gjithë sektorët, si dhe në nivel familjar dhe individual.
- Parimi themelor i kësaj qasjeje është gjithëpërfshirja në marrjen e vendimeve të përbashkëta dhe ndërtimi i konsensusit duke u bazuar në një proces të gjerë konsultimi me të gjithë palët e interesuara, të bazuar në parimet demokratike të transparencës, informimit dhe të kuptuarit konsekuent të shtrirjes së zbatimit, si dhe të vullnetarizimit, barazisë dhe mosdiskriminimit.
- Gjithëpërfshirja është e domosdoshme, sepse ndërtimi i rezistencës ndaj dezinformatave është një çështje që ka dimensione të shumëfishta - nga siguria kombëtare e deri te promovimi i lirive të mediave, lufta kundër korrupsionit dhe forcimi i rolit të shoqërisë civile si nxitës i demokratizimit, dhe kërkon një qasje multidisiplinare dhe veprim proaktiv të institucioneve shtetërore në kuadër të kompetencave të tyre.
- Duke marrë parasysh polarizimin dhe fragmentimin e lartë në shoqëri në shumë linja, gjatë përgatitjes së ndërhyrjeve kundër dezinformatave, është e rëndësishme të merren vendime të bazuara në të dhëna në lidhje me atë se, në një situatë të caktuar a është efektive të zbatohet një qasje konfrontuese (përmes së cilës mund të forcohet polarizimi ) ose të insistohet që përmes një dialogu të gjerë dhe gjithëpërfshirës shoqëror t'u jepet shans të gjitha palëve që të rishqyrtojnë disa nga vlerat, perceptimet dhe mendimet e tyre.
- Ndjeshmëria e popullatës ndaj fushatave dezinformuese, teorive konspirative dhe narrativeve të tjera alternative është pasojë e faktorëve strukturorë, të cilët duhet të trajtohen me programe konkrete, në vend që të patologizohen apo me praktika politizimi, refuzimi apo injorimi.

### REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET SHTETËRORE

- Fluksi i dezinformatave nuk është vetëm problem i mediave dhe gazetarisë profesionale, por është një problem më i gjerë i sigurisë dhe pikërisht për këtë, qeveria dhe institucionet e tjera kompetente duhet ta udhëheqin procesin e përballjes me të, pasi formësimi i zgjidhjeve duhet të bazohet në parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, të cilat artikuloohen në mënyrë proaktive nga organizatat qytetare dhe mediatike.
- Institucionet, në partneritet me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të krijojnë politika, strategji dhe mekanizma publike për të rritur rezistencën ndaj dezinformatave dhe për të zhvilluar edukimin mediatik, duke pasur parasysh se kjo çështje e sigurisë shkon përtej sferës mediatike dhe duhet të përfshijë bashkëpunimin me të gjithë institucionet kompetentët shtetërore.
- Duke marrë parasysh natyrën multidisiplinare të problemit të dezinformatave, ky proces duhet të konsiderohet kompatibil dhe komplementar me procesin e zbatimit të prioritetëve urgjentë të reformës në fushën e mediave, të cilat janë pjesë e domosdoshme e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe nevojën për harmonizimin urgjent të kornizës ligjore me të gjitha direktivat dhe rregullativat përkatëse të BE-së, veçanërisht ato që e trajtojnë çështjen e përhapjes së dezinformatave, përmbajtjeve që nxisin gjuhën e urrejtjes, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit.
- Institucionet shtetërore duhet të iniciojnë një proces për krijimin dhe/ose përmirësimin e politikave publike, listave prioritare dhe/ose strategjive në nivel shtetëror për të luftuar dezinformatat, i cili do të marrë parasysh përvojat nga aplikimi i “Propozim-Planit për Veprim Vendimtar kundër Përhapjes së Dezinformatave”, si dhe nevojat për përmirësimin e tij në kushtet e një pandemie dhe rrethanave të ndryshuara gjeopolitike e të tjera. Pavarësisht se çfarë forme do të kenë dokumentet, planet shoqëruese të veprimit duhet të përmbajnë qëllime konkrete, institucionet përgjegjëse, burimet e alokuara dhe afatet kohore.
- Institucionet shtetërore duhet gjithashtu të përmirësojnë kodet etike dhe procedurat e brendshme që zbatohen për punonjësit e institucioneve për të inkorporuar luftën kundër dezinformatave si vlerë thelbësore dhe zhvillimin e mëtejshëm të procedurave adekuate të punës dhe protokolleve të sigurisë.
- Është e nevojshme të forcohet edhe më tej rezistenca ndaj dezinformatave midis nëpunësve shtetërorë dhe publikë përmes përmirësimit të sistemeve të ngritjes së kapaciteteve, duke integruar përmbajtje nga kjo fushë në programet mësimore për ngritjen profesionale, me qëllim të forcimit të vetëdijes dhe fitimit të aftësive konkrete në fushën e edukimit mediatik dhe digjital.
- Të gjitha institucionet e shtetit duhet të ngrenë nivelin e hapjes dhe transparencës proaktive, që do të mundësojë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe më efektive për përpjekjet e mediave, shërbimeve dhe organizatave që punojnë drejtpërdrejt për zbulimin e dezinformatave.
- Institucionet shtetërore, nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, duhet të kenë një rol proaktiv në forcimin e kapaciteteve financiare të mediave dhe të organizatave mediatike dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime financiare në industrinë e mediave. Është veçanërisht e rëndësishme të investohet në forcimin e mekanizmave të vetë-rregullimit dhe ndërgjegjësimin për rolin e mediave si shtytës të demokracisë në shoqëri. Përmirësimi i situatës me mediat duhet trajtuar si një objektiv strategjik.
- Institucionet shtetërore nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv duhet të marrin një rol proaktiv në krijimin e një mjedisi ligjor dhe shoqëror të favorshëm/mundësues për forcimin e kapaciteteve financiare të mediave dhe të organizatave mediatike, si dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm

për investime financiare në industrinë e mediave. Është veçanërisht e rëndësishme të përmirësohen kushtet ligjore për investimin në forcimin e mekanizmave të vetë-rregullimit, si dhe të bëhet ndërgjegjësimi për rolin e mediave si shtytës të demokracisë në shoqëri, ndërsa përmirësimi i situatës me gazetarinë duhet të trajtohet si një qëllim strategjik.

- Qeveria e RMV-së duhet ta përfundojë zbatimin e pjesës së dytë të Planit të Propozuar të Veprimit nga viti 2019, të titulluar "Masat Proaktive", në veçanti:
  - Të krijojë një strukturë - grup pune për konsultime dhe vendimmarrje, në të cilin do të jenë anëtarë përfaqësues të të gjitha palëve të interesuara nga sektori civil dhe institucionet përkatëse;
  - Të gjendet një model për zhvillimin e fushatave edukative me interes të lartë publik që synojnë rritjen e rezistencës ndaj dezinformatave, sipas një modeli transparent dhe llogaridhënës, i cili do të parandalojë korrupsionin e mediave përmes transferimit të parave të shtetit.
  - Të vazhdohet diskutimi me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile për mënyrën e mbështetjes për prodhimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik, veçanërisht të përmbajtjeve edukative në temën e luftimit të dezinformatave duke u bazuar në parimet e transparencës dhe llogaridhënies.
  - Të vazhdohet dhe të forcohet bashkëpunimi me të gjitha mediat dhe organizatat profesionale që punojnë për verifikimin e fakteve dhe/ose demaskimin e dezinformatave, si një aspekt kyç i mekanizmave të transparencës dhe marrëdhënieve me publikun.
- Institucionet shtetërore duhet të nisin një proces për krijimin e një dokumenti kornizë strategjik që do të parashikojë hapa konkretë për të luftuar dezinformatat, që do t'i marrë parasysh edhe përvojat nga aplikimi i Propozim-Planit të Veprimit.
- Pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duhet të ofrojnë mbështetje të shtuar buxhetore për hulumtimet shkencore mbi praninë dhe efektet e dezinformatave në shoqëri.

---

## REKOMANDIME PËR PARTITË POLITIKE DHE POLITIKANËT

- Partitë politike nuk duhet t'i përdorin dezinformatat si një element të luftës politike dhe duhet të krijojnë (ose të përmirësojnë) strukturat dhe mekanizmat e brendshme partiake, procedurat dhe kodet etike me qëllim të ndërtimit të rezistencës ndaj dezinformatave në mesin e anëtarëve të tyre dhe te publiku i gjerë.
- Politikanët individualë, si pjesë e luftës së tyre legjitime politike, nuk duhet të përhapin dezinformata përmes të gjitha formave të komunikimit publik që janë në dispozicion të tyre, si në foltoren e parlamentit, rrjetet sociale, paraqitjet në media, mjetet e informimit të partive dhe në kontaktet e përditshme me qytetarët.
- Partitë politike duhet të përmbahen nga përdorimi i strukturave të organizuara në rrjetet sociale (fermë e trolleve ose fabrikë e trolleve) për përhapjen e orkestruar keqdashëse të dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e dhunës.

---

## REKOMANDIME PËR KOMPANITË PRIVATE, AGJENCITË E MARKETINGUT DHE REKLAMUESIT E TJERË QË U MUNDËSOJNË PUNË SHTËPIVE MEDIATIKE

- Reklamuesit duhet t'i përmirësojnë kodet e tyre etike dhe politikat e përgjegjësisë shoqërore të kompanisë me kritere që do të mundësojnë monitorim të rregullt nëse me mjetet e tyre sponsorizohen media që përhapin dezinformata.
- Duke i ndjekur përvojat dhe praktikat e mira të deritanishme, komuniteti i biznesit, përkatësisht reklamuesit, duhet të kenë parasysh zgjidhjet ekzistuese vetë-rregulluese, duke përfshirë edhe regjistrin e mediave profesionale "ProMedia", anëtarët e të cilit janë të detyruar të përmbushin minimumin e standardeve profesionale.

---

## REKOMANDIME PËR MEDIAT INDIVIDUALE, PUNONJËSIT E MEDIAVE, GJEGJËSISHT GAZETARËT

- Punonjësit e mediave, si dhe mediat në tërësi, duhet të angazhohen për respektimin më të madh të standardeve profesionale dhe etike në gazetari, si dhe për rritjen e zbatimit të mjeteve të vetë-rregullimit.
- Mediat duhet të marrin pjesë aktive në luftën kundër të gjitha llojeve të dezinformatave dhe në promovimin e edukimit mediatic duke e rritur cilësinë dhe shumëllojshmërinë e programeve mediatike me karakter informativ dhe edukativ.
- Pronarët dhe menaxhmenti i mediave duhet të investojnë në ndërtimin e kapaciteteve për verifikimin e fakteve përpara publikimit, gjë që do ta bëjë vetë median më konkurruese dhe të njohur si cilësore nga audiencia e tyre.
- Mediat që nuk kanë përmbajtjen e tyre të dedikuar për të luftuar dezinformimin, duhet të angazhohen për të transmetuar përmbajtje të prodhuara nga shërbimet për verifikimin e fakteve ose mediat që ekspozojnë dhe demaskojnë rregullisht dezinformata në kuadër të punës së tyre.

---

## REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT PROFESIONALE MEDIATIKE DHE ORGANET E NGJASHME

- Është e nevojshme të rritet bashkëpunimi ndërmjet organizatave profesionale mediatike, si dhe institucioneve të tjera relevante për sektorin e medias.
- Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të forcohet edhe më tej promovimi i mekanizmave të vetë-rregullimit si mjet përmes të cilit qytetarët kanë mundësinë të vënë në dukje keqpërdorimet nga ana e mediave joetike.
- Verifikimi i fakteve, përveç si vlerë gazetareske, duhet të afirmohet edhe si një formë e vetë-rregullimit brenda komunitetit mediatik, por edhe si një mjet për të nxitur debatin publik për cilësinë e përmbajtjeve mediatike dhe një lloj edukimi joformal me të cilin standardet profesionale në një mënyrë praktike sillen më afër audiencës më të gjerë.

---

## REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

- Organizatat civile duhet të vazhdojnë me krijimin dhe akumulimin e njohurive që lidhen me problemin e dezinformatave, duke ndërtuar arkiva publike të përmbajtjeve ku do të mblidhen njohuri dhe shpjegime për manipulimet dhe dezinformatat e ekspozuara, të cilat do të publikohen me licenca që lejojnë përdorimin nga organe të tjera.
- Më shumë organizata duhet të zotohen se do të fillojnë projektet e tyre me të cilat do të punojnë për ndërgjegjësimin e publikut për dezinformimin ose t'i bashkohen projekteve të asaj pjese të sektorit joqeveritar që tashmë punon në zbulimin dhe demaskimin (ang. debunking) e dezinformatave. Me këtë rast, ato duhet të punojnë në diversifikimin e grupeve të synuara në komunitetet e tyre që ato i konsiderojnë se janë më të ndjeshme ndaj ndikimit negativ të dezinformatave. Të formulohen qasje të ndryshme për të shpjeguar dëmin e dezinformimit midis grupmoshave të ndryshme, me theks të veçantë tek të rinjtë.
- Organizatat civile duhet të krijojnë përmbajtje dhe fushata promovuese, me të cilat publikut do t'i paraqesin narrative pozitive, të bazuara në fakte, në të cilat do të prezantohen masat për parandalimin e përhapjes së epidemive dhe përfitimet e vaksinimit, për të reduktuar hezitimin ndaj vaksinave, por edhe për të kundërshtuar përdorimin e vaksinave kundër Covid-19, lisë dhe sëmundjeve të tjera që mund të parandalohen me vakcina. Kjo është veçanërisht urgjente duke pasur parasysh se në disa vende fqinje po rikthehen sëmundjet që u zhdukën përmes vaksinimit.
- Më shumë organizata lokale të shoqërisë civile duhet të përfshihen në përpjekjet për të rritur edukimin mediatik dhe të menduarit kritik në komunitetet e tyre, edhe atë në të gjitha nivelet: përmes kurrikulave që do t'i krijojnë në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me komunitetin akademik, të zhvilluara posaçërisht për të luftuar dezinformatat në lidhje me mjekësinë (p.sh. vaksinat) dhe sistemin shëndetësor, duke iu referuar praktikës aktuale të verifikuesve të fakteve në vend. Konkretisht, kjo do të thotë bashkëpunim mes gazetarëve dhe ekspertëve të specializuar në fushat që janë objekt i dezinformatave, njohuritë profesionale të të cilëve duhet të jenë baza e demaskimit.
- Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e edukimit mediatik dhe verifikimit të fakteve do ta rrisin ndikimin e tyre dhe mundësitë për bashkëpunim duke iu bashkuar Rrjetit Kombëtar të Edukimit Mediatik dhe rrjeteve rajonale ose ndërkombëtare të dedikuara për të luftuar dezinformimin.

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të fillojnë ose të intensifikojnë aktivitetet e tyre për lobim dhe përfaqësim para qeverisë për të rritur mbështetjen e institucioneve publike dhe shtetërore në luftën kundër dezinformatave dhe forcimin e edukimit mediatik dhe fuqizimin e opinionit kritik, si dhe të insistohet që organet përkatëse shtetërore (prokuroria, gjyqësori) t'i zbatojnë ligjet përkatëse kundrejt mosndëshkimit për veprat penale që e kërcënojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e qytetarëve për informim të drejtë dhe të saktë.